



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION**

Në bazë të paragrafit 6.5 dhe 10.3 të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës të datës 24 nëntor 2018, Bordi i Federatës miraton këtë:

RREGULLORE #04

PËR

PIKËT E RANGIMIT DHE RANKINGU ZYRTAR

VERSIONI 1.2



PËRMBAJTJA

1. Përkufizimet	2
2. Qëllimi	2
3. Grupmoshat Kuq, Portokall, Gjelbër (“ROG”).....	2
4. Rregullat e përgjithshme	3
5. Rregullat specifike për grupmoshat U12-U16	4
6. Rregullat specifike për grupmoshën U18.....	5
7. Rregullat specifike për Kategorinë “A”	6
8. Rregullat specifike për Kategorinë “35+”	7
9. Kampionatet e miqësura	7
10. Rankingu gjatë periudhës së Covid - 19.....	8
11. Dispozitat përfundimtare dhe të tjera	8

VERSIONET E DOKUMENTIT

Versioni	Në fuqi	Aprovoi / Data e aprovimit	Ndryshimet
1.0	01.01.2019	Bordi / 19.03.2019	-
1.1	01.01.2020	Bordi / 15.01.2020	4.3. Pikët tashmë të publikohen ditën e hënë. 4.10. Pikët për turnetë Master të fundvitit tashmë rregullohen me rregulloren për turnetë Masters. 9.3.1. Kampionati i Maqedonisë Veriore heqet nga lista e kampionateve që merren parasysh për qëllime rankimi
1.2.	15.07.2020	Bordi/ 15.07.2020	10. Rankingu gjatë periudhës së Covid - 19



1. Përkufizimet

Administrata	Administrata e Federatës me të cilën udhëheq Sekretari
Anëtar	Anëtar i Federatës
Bordi	Bordi Ekzekutiv i Federatës
ETF	Federata Evropiane e Tenisit
Federata	Federata e Tenisit e Kosovës
Kampionatet e miqësura	Kampionatet e federatave rajonale me të cilat Federata ka marrëveshje që tenistët kosovarë të luajnë në to.
ITF	Federata Ndërkombëtare e Tenisit
Mbikëqyrësi	Referi kryesor, mbikëqyrës i turneut
ROG	Grupmoshat U08, U09, U11
Sekretari	Sekretari i Përgjithshëm i Federatës

2. Qëllimi

- 2.1. Përmes kësaj rregulloreje, për të gjitha grupmoshat, rregullohen pikët që tenistët fitojnë në turnetë përkatëse të Federatës.
- 2.2. Njëkohësisht rregullohen ranglistat e Federatës, afatet dhe përgjegjësitë e publikimit të tyre si dhe turnetë që merren parasysh kur përpilohen ato lista.

3. Grupmoshat Kuq, Portokall, Gjelbër (“ROG”)

- 3.1. Për grupmoshat ROG nuk mbahet ranglista.
- 3.2. Për qëllime informimi, lista e përmbledhur dhe e përditësuar e arritjeve gjatë një viti kalendarik, pas çdo turneu iu dërgohet klubeve, trajnerëve, referëve dhe Këshillit Profesional.
- 3.3. Lista përfshin informacionet për çdo tenist:
 - 3.3.1. Numrin e turneve pjesëmarrës;
 - 3.3.2. Numrin e turneve të fituar;
 - 3.3.3. Numrin e turneve finalist;
 - 3.3.4. Numrin e turneve gjysmëfinalist;
 - 3.3.5. Numrin e turneve ku nuk del nga grupi (Round Robin);
 - 3.3.6. Numrin e meçeve të fituara dhe të humbura gjithsej;
 - 3.3.7. Numrin e meçeve të fituara dhe të humbura në grup;



4. Rregullat e përgjithshme

- 4.1. Tenisti duhet ta ketë paguar anëtarësinë në mënyrë që të fitojë të drejtën për t'u ranguar.
- 4.2. Për qëllime të kalkulimit të pikëve të rangimit për një javë të caktuar, merren parasysh pikët e fituara në 52 javët e fundit sipas grupmohave përkatëse.
- 4.3. Rangimi merr parasysh pikët e publikuara deri në mesditë ditën e hënë, dhe lista azhurnohet deri në fund të asaj dite.
- 4.4. Tenistët me pikë të barabarta rangohen sipas renditjes në ranglistën e javës paraprake.
- 4.5. Tenisti që nuk kualifikohet nga shorti kualifikues në shortin kryesor, nuk fiton pikë. Për qëllime të këtij paragrafi, Humbësi Fatlum *“Lucky Loser”* konsiderohet të jetë kualifikuar për short kryesor.
- 4.6. Tenisti që humb në xhiron e dytë, ndërkohë që xhiron e parë e ka kaluar pa kundërshtar (*“Bye”*), merr pikët e parapara për xhiron e parë.
- 4.7. Tenisti i cili pa arsye objektive (lëndim, sëmundje, rast vdekje) tërhiqet nga turneu pasi të jetë hedhur dhe publikuar shorti kryesor (nuk paraqitet/luan meçin e parë) ndëshkohet me minus pikët e xhiros së parë. E njëjta vlen edhe nëse tenisti në xhiron e parë e ka kaluar me *“Bye”*.
- 4.8. Tenisti i cili pa arsye objektive tërhiqet nga turneu në xhirot e mëtutjeshme, përfundon me pikët sikurse të kishte humbur në xhiron paraprake.
- 4.9. Pikët e fituara në turnetë apo kampionatet e mbyllura ndërkombëtare (si p.sh. paraqitjet në përfaqësuese, turne zhvillimorë, gara olimpike, etj.), nuk merren parasysh.
- 4.10. Turnetë e fundvitit Master / Kampionatit Shtetëror rregullohen me rregullore të veçanta.
- 4.11. Pikët e fituara në konkurrencën e çifteve nuk merren parasysh në rangimin individual.
- 4.12. Turnetë në të cilën luajnë tre (3) apo më pak tenistë, nuk merren parasysh për qëllime të rangimit.
- 4.13. Pikët e tenistit të fituara në një grupmoshë barten në masën 30% kur tenisti kalon në grupmoshën sipër. Ky rast vlen vetëm nëse tenisti gjatë vitit paraparak nuk ka luajtur asnjë turne në grupmoshën në të cilën kalon.
- 4.14. Pikët e bartura nga grupmosha paraprake sipas paragrafit 4.13 zëvendësohen gradualisht me pikët e fituara në grupmoshën e re.

5. Rregullat specifike për grupmoshat U12-U16

5.1. Në rangim merren parasysh pikët e fituara në:

- 5.1.1. Turnetë e Federatës; dhe
- 5.1.2. E fshirë (Turnetë në Kampionatet e miqësuar); dhe
- 5.1.3. Turnetë e ETF.

5.2. Rangu i turneve nën 5.1.1 dhe 5.1.2 përcaktohet në bazë të numrit të tenistëve pjesëmarrës, gjegjësisht madhësisë së shortit kryesor, si në vijim:

Nr. i tenistëve	Rangu	Shorti kryesor
17+	4	32
9-16	5	16
5-8	6	8
4	7	4

5.3. Pikët e fituara bazohen në rangun e turneut dhe pozitën / xhiron në të cilën përfundon tenisti sipas tabelave në vijim:

5.3.1. Grupmosha U12

Klasifikimi	ETF	Rang 4	Rang 5	Rang 6	Rang 7
Kampion	42.00	29.40	24.50	19.60	14.70
Finalist	35.00	24.50	20.42	16.33	12.25
Gjysmë-finalist	21.00	14.70	12.25	9.80	7.35
Çerek-finalist	14.00	9.80	8.17	6.53	
Xhiro e 16-ve	10.50	7.35	6.13		
Xhiro e 32-ve	7.00	4.90			

5.3.2. Grupmosha U14

Klasifikimi	Rang 4	Rang 5	Rang 6	Rang 7
Kampion	42.00	35.00	28.00	21.00
Finalist	35.00	29.17	23.33	17.50
Gjysmë-finalist	21.00	17.50	14.00	10.50
Çerek-finalist	14.00	11.67	9.33	
Xhiro e 16-ve	10.50	8.75		
Xhiro e 32-ve	7.00			

5.3.3. Grupmosha U16

Klasifikimi	Rang 4	Rang 5	Rang 6	Rang 7
Kampion	84.00	70.00	56.00	42.00
Finalist	70.00	58.34	46.66	35.00
Gjysmë-finalist	42.00	35.00	28.00	21.00
Çerek-finalist	28.00	23.34	18.66	
Xhiro e 16-ve	21.00	17.50		
Xhiro e 32-ve	14.00			

6. Rregullat specifike për grupmoshën U18

6.1. Në rangim merren parasysh pikët e fituara në:

- 6.1.1. Turnetë e Federatës; dhe
- 6.1.2. Turnetë në kampionatet e miqësura; dhe
- 6.1.3. Turnetë e ITF Juniors.

6.2. Rangu i turneve nën 6.1.1 dhe 6.1.2 përcaktohet në bazë të numrit të tenistëve pjesëmarrës, gjegjësisht madhësisë së shortit kryesor, si në vijim:

Nr. i tenistëve	Rangu	Shorti kryesor
17+	6	32
9-16	7	16
5-8	8	8
4	9	4

6.3. Pikët e fituara bazohen në rangun e turneut dhe në pozitën / xhiron në të cilën përfundon tenisti sipas tabelës në vijim:

Klasifikimi	Rang 6	Rang 7	Rang 8	Rang 9
Kampion	10.00	5.00	2.50	1.25
Finalist	6.00	3.00	1.50	0.75
Gjysmë-finalist	3.60	1.80	0.90	0.50
Çerek-finalist	2.00	1.00	0.50	
Xhiro e 16-ve	1.00	0.50		
Xhiro e 32-ve	0.50			

7. Rregullat specifike për Kategorinë “A”

7.1. Në rangim merren parasysh pikët e fituara në:

- 7.1.1. Turnetë e Federatës; dhe
- 7.1.2. Turnetë në kampionatet e miqësura; dhe
- 7.1.3. Turnetë e ATP/WTA/ITF Pro Tour.

7.2. Rangu i turneve nën 7.1.1 dhe 7.1.2 përcaktohet në bazë të numrit të tenistëve pjesëmarrës, gjegjësisht madhësisë së shortit kryesor, si në vijim:

Nr. i tenistëve	Rangu	Shorti kryesor
17+	6	32
9-16	7	16
5-8	8	8

7.3. Pikët e fituara bazohen në rangun e turneut dhe në pozitën / xhiron në të cilën përfundon tenisti sipas tabelës në vijim:

Klasifikimi	Rang 6	Rang 7	Rang 8
Kampion	25.00	12.50	6.25
Finalist	15.00	7.50	3.75
Gjysmë-finalist	9.00	4.50	2.25
Çerek-finalist	4.50	2.25	1.13
Xhiro e 16-ve	2.00	1.00	
Xhiro e 32-ve	1.20		

8. Rregullat specifike për Kategorinë “35+”

- 8.1. Në rangim merren parasysh vetëm pikët e fituara në turnetë e Federatës.
- 8.2. Rangu i turneve nën 8.1 përcaktohet në bazë të numrit të tenistëve pjesëmarrës, gjegjësisht madhësisë së shortit kryesor, si në vijim:

Nr. i tenistëve	Rangu	Shorti kryesor
17+	3	32
9-16	4	16
9-12	4	RR
5-8	5	RR
4	6	RR

- 8.3. Pikët e fituara bazohen në rangun e turneut dhe në pozitën / xhiron në të cilën përfundon tenisti sipas tabelës në vijim:

Shorti me Eliminim	Shorti me RR	Rang 3	Rang 4	Rang 5	Rang 6
Kampion	Vendi 1	80	60	40	20
Finalist	Vendi 2	60	30	20	10
Gjysmë-finalist	Vendet 3-4	30	20	10	5
Çerek-finalist	Vendet 5-8	20	10	5	
Xhiro e 16-ve	Vendet 9-16	10	5		
Xhiro e 32-ve	Vendet 17-32	5			

9. Kampionatet e miqësura

- 9.1. Kampionatet e miqësura përfshijnë kampionatet e federatave rajonale me të cilat Federata ka marrëveshje që tenistët kosovarë të luajnë në to.
- 9.2. Marrëveshjet e tilla arrihen (apo shkëputen) me vendim të Bordit, dhe hyjnë në fuqi nga viti i ardhshëm kalendarik kur edhe i bashkëngjiten kësaj rregulloreje.
- 9.3. Kampionatet e miqësura janë (viti në fuqi në kllapa):

9.3.1. Nuk ka të Kampionate të Miqësura (2020).

10. Rankingu gjatë periudhës së Covid - 19

- 10.1. Gjatë kësaj periudhe vlejnë pikët e turneve të fituara nga tenistët që nga turneu i parë i vitit 2019, duke llogaritur pikët e fituara gjatë 104 javëve të fundit.
- 10.2. Ndër këto rezultate, në rankim do të përfshihen rezultatet nga 6 turnetë ku tenisti ka fituar më së shumti pikë.
- 10.3. Për tenistin që ka ndërruar grupmoshën, në përzgjedhjen e 6 turneve për qëllime të pikës 2, prioritetet kanë turnetë e grupmoshës së re që tenisti i ka luajtur. Në rast se tenisti i ka luajtur më pak se 6 turne në grupmoshën e re, atëherë turnetë e mbetura plotësohen me turnetë e grupmoshës paraprake.
- 10.4. Për shkak të dallimit të madh në pikëzim në mes të kategorisë U16 dhe U18, pika 3 e këtij vendimi, në rastin e kalimit prej kategorisë U16 në kategorinë U18, modifikohet si në vijim: Pikët e fituara vitin e kaluar në kategorinë U16 pjesëtohen me faktorin 14, për t'i bërë ekuivalente pikët e të dyja kategorive.
- 10.5. Paragrafi 4.13 i kësaj rregulloreje pezullohet gjatë periudhës sa vlen ky nen.
- 10.6. Ky ndryshim vlen nga java 27 e vitit 2020 deri në javën 26 të vitit 2021.

11. Dispozitat përfundimtare dhe të tjera

- 11.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2019 dhe aplikohet në mënyrë retroaktive për 12 muajt e fundit.
- 11.2. Kjo rregullore shfuqizon nenin 10 “Ranglistat” të “Rregullores për Turnetë Individuale” të datës 12 janar 2012, si dhe të gjitha seksionet e rregulloreve apo vendimet e tjera të Bordit që janë në kundërshtim me të.
- 11.3. Ankesat në lidhje me pikët dhe ranglistat i drejtohen:
 - 11.3.1. Administratës - për gabime teknike, që duhet zgjidhur brenda 48 orësh; ose
 - 11.3.2. Komisionit për Ankesa në kuadër të Federatës - për ankesa që duhet zgjidhur brenda 30 ditësh.
- 11.4. Interpretimi përfundimtar i kësaj Rregulloreje është kompetencë e Bordit.



Mejdi Rexhepi
Kryetar
Federata e Tenisit e Kosovës



Prishtinë, 15 Korrik 2020